



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQERIA ECO-ELB sh.a.

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Date \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “N O SH I”, me NIPT: J91524007E, dhe adrese Tirane, Kashar, Servis, Autostrada Tr-Dr, Km 7.

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar - MALLRA**

Numri i procedurës / referenca e Lotit I: **REF-08475-06-07-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

**Objekti: “Blerje Automjet Fuoristradë”**

**Numri i Referencës / Lotit: “REF-08475-06-07-2024”**

**Afatet e lëvrimit: 15 ditë nga data e lidhjes së kontratës.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “Albania Motor Company” me NIPT **K41829010I** dhe vlere te ofertes se tij **1,900,000** (një milion e nëntëqind mijë) Lekë **pa TVSH**.
2. Operatori Ekonomik “CompiTel” me NIPT **M31417021V** dhe vlere te ofertes se tij **2,000,000** (dy milion) Lekë **pa TVSH**.
3. Operatori Ekonomik “N O SH I” me NIPT **J91524007E** dhe vlere te ofertes se tij **2,065,500** (dymilion e gjashtëdhjetë e pesëmijë e pesqind) Lekë **pa TVSH**.

**JANË SKUALIFIKUAR OPERATORËT E MËPOSHTËM:**

1. Operatori Ekonomik “Albania Motor Company” me NIPT **K41829010I** dhe vlere te ofertes se tij **1,900,000** (një milion e nëntëqind mijë) Lekë **pa TVSH**.

## ARSYEJA SKUALIFIKIMIT

### **Operatori ekonomik “Albania Motor Company” nuk përmbush pikën 2.3.3 gërma “ii”**

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqese nje deklarate se me dorezimin e mjeteve motorike objekt i procedures se prokurimit detyrimisht do te jenë të likujduara te gjitha pagesat ne lidhje me:

- Tarifen e kontrollit fizik
- Tarifen e regjistrimit (targat)
- Taksat vjetore
- Pagesen per Kontrollin teknik (kur nuk perjashtohet nga DPSHTRR)
- Pagesat per TPL dhe Kasko
  - i. Operatori Ekonomik ofertues duhet të kete statusin Aktiv ne QKB ku ne ekstrakt te kete te përcaktuar ne nje nga pikat e objektit të aktivitetit te jete shitblerja e automjeteve ose ekuivalente.
  - ii. OE konkurues duhet të paraqesë katalogun e automjetit, ose pjesë të shkëputura nga katalogu, ku të tregohet tipi i automjetit dhe parametrat e kërkuar të tij në specifikimet teknike.

**OE “Albania Motor Company” nuk ka paraqitur katalogun e automjetit, ose pjese te shkeputur nga katalogu.**

**OE ne deklaratat e paraqitura nuk merr persiper tarifen e kotrollit Teknik si kerkohet ne piken 2.3.3**

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

**Sa mesiper, operatori “Albania Motor Company” sh.p.k. nuk kualifikohet.**

2. Operatori Ekonomik “CompiTel” me NIPT **M31417021V** dhe vlere te ofertes se tij **2,000,000** (dy milion) Lekë **pa TVSH.**

## ARSYEJA SKUALIFIKIMIT

Referuar Ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, I ndryshuar

Neni 76, Kriteret detyruese për skualifikim

Pika 3, Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

gërma dh, ku thuhet: “operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja”.

OE “CompiTel” është shpallur fitues për procedurën “Blerje Automjet Fuoristrade” me numër reference REF-00095-04-04-2024, procedure per te cilen OE është njoftuar në sistem elektronik të prokurimeve dhe nuk është paraqitur për të sjellë sigurimin e kontratës dhe nënshkrimin e saj.

Sa më sipër AK ka kërkuar me anë të shkresës me Nr. Prot. 233 datë 21.05.2024 konfiskimin e sigurimit të ofertës.

**Sa mesiper, operatori “Compi Tel” nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.**

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “**N O S H I**”, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **2,065,500** (dymilion e gjashtëdhjetë e pesëmijë e pesqind) Lekë **pa TVSH**, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Konceptoi: Jurist A. Lleshi

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**ADMINISTRATORI**

**Leli KAJA**